



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
REKTOR

R R E G U L L O R E

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E

LABORATORIT MULTIMEDIAL UNIVERSITAR

UniVlora

NË

UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”

VLORE

Miratuar me Vendim nr.94, dt.12.12.2024 të Senatit Akademik të UV-së, i ndryshuar me
Vendim nr 98, dt.16.10.2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR**

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
LABORATORIT MULTIMEDIAL UNIVERSITAR UniVlora**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mirëadministrimin e **Laboratorit Multi-medial Universitar (LM-UniVlora)** për llogari të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë si dhe përcaktimin e procedurave të funksionimit të tij.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet bazuar në nenin 38, pika 1, gërma d, nenit 132 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19, pika, gërma dh) të Statutit të UV-së, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Konventës Europiane për të drejtat e njeriut, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 për "Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e faqeve/mediave sociale për llogari të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë miratuar me Vendim Senati Akademik nr.40, datë 23.09.2024.

**Neni 3
Qëllimi**

1. Qëllimi kryesor i laboratorit mediatik universitar është të krijojë një mjedis arsimor që angazhon studentët nëpërmjet vullnetarizmit dhe i përgatit ata për sfidat e botës moderne përmes përdorimit të teknologjive të avancuara dhe mjeteve multimediale.
2. Laboratori mediatik i UV-së ka për qëllim promovimin e aktiviteteve si dhe të ndërmarrë iniciativa që synojnë posaçërisht forcimin dhe rritjen e imazhit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, me qëllim krijimin e një rrjeti profesionistësh dhe figurash që zotërojnë aftësi specifike komunikimi, përmes përfshirjes së personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ, studentëve dhe të sapo diplomuarit.
3. Laboratori synon të zhvillojë aftësi kritike, krijuese dhe teknologjike që janë thelbësore për suksesin e studentëve në një shoqëri gjithnjë e më digjitale, duke i mundësuar atyre të krijojnë, eksplorojnë dhe mësojnë në mënyra të reja dhe inovative.
4. Edukimin e aftësimin e studenteve nëpërmjet vullnetarizmit për të krijuar produkte mediatike me teknologji të reja në mjedis multi medial.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË REKTOR

5. Realizimi i kurseve dhe praktikave të studenteve duke ofruar kombinimin e njohurive bashkëkohore me studime teorike –praktike.
6. Edukimin e studenteve si qytetare mediatik me aftësi ,shkathtësi dhe njohuri të avancuara të edukimit mediatik të cilët duke operuar me përgjegjësi do ta faktojnë realitetin studentor, shoqëror dhe universitar në mënyrë kreative duke vepruar me përgjegjësi sociale dhe etike.

Neni 4 Vizioni dhe Misioni

1. Laboratori multimedial i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë është një hapësirë që kombinon teknologjinë, kreativitetin dhe mësimdhënien inovative për të krijuar një përvojë mësimore më të pasur dhe më efektive. Ai është një hapësirë shumë funksionale dhe inovative që i mundëson studentëve, pedagogëve dhe profesionistëve të angazhohen në krijimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes mediatike.
2. Një laborator mediatik arsimor që përfshin radio, podcast, gazetë, botime, dhe librotekë është një hapësirë e jashtëzakonshme për zhvillimin e aftësive profesionale dhe krijuese për studentët, kërkuesit dhe pedagogët.
3. Ky lloj mjedisi edukativ jo vetëm që mundëson zhvillimin e aftësive teknologjike por gjithashtu stimulon mendimin kritik, kreativitetin dhe bashkëpunimin midis studentëve dhe stafit akademik.
4. Laboratori duhet të mbështesë inovacionin dhe të kontribuojë në zhvillimin e industrisë mediatike dhe komunikimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Të jetë lider në aplikimin e qasjeve inovative duke u ofruar studentëve, stafit akademik dhe komunitetit, përvoja transformuese në shërbim të zhvillimit personal dhe shoqëror në shekullin e globalizmit.
5. Ky laborator do të shërbejë si një hapësirë që integron mjetet digjitale dhe mjetet e ndryshme vizuale, akustike dhe interaktive për të mundësuar një mësim dhe eksplorim më të thelluar të njohurive.
6. Të inkurajoj kreativitetin, të menduarit kritik, vlerat universale tek studentet me qëllim të realizimit të ideve dhe projekteve inovative.
7. Të sigurojë një mjedis mësimor që rezulton me mobilitet social, akademik dhe profesional në zhvillimin e studentit si individ dhe qytetar i përgjegjshëm dhe të zhvilloj dialog dinamik me partnerët social dhe komunitetin si dhe të bashkohet me rrjetet e arsimit të lartë të shkencës në Europë dhe më gjërë. Ai ofron mundësi të shumta për përdorimin e mjeteve multimediale dhe të teknologjisë për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje të pasur dhe edukative, duke kontribuar në një proces mësimor dhe kërkimor dinamik dhe inovativ.
8. Laboratori do të mbështesë veprimtarinë kërkimore shkencore të institucionit nëpërmjet përfshirjes dhe bashkëpunimit në projekte në nivel institucional, kombëtare dhe ndërkombëtare. Duke mundësuar garantimin në një rrjet të fortë marrëdhëniesh me institucione dhe biznese, që mundëson përditësime të vazhdueshme të linjave më inovative të kërkimit shkencor në përputhje me fushat e studimit të institucionit.
9. Laboratori duhet të ofrojë mundësi për të gjithë studentët duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE REKTOR

10. Misioni i saj është të sigurojë një kuadër të qartë dhe të rregullt për përdorimin e burimeve dhe pajisjeve të laboratoit, duke garantuar një përdorim të sigurt, etike dhe produktiv.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore i shtrin efektet e saj në të gjitha organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, ndihmëskadernik, personelin administrativ, studentët e Universitetit “Ismael Qemali” Vlorë

Neni 6

Fushëveprimi i rregullores

1. Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje mbulon të gjitha aspektet që lidhen me menaxhimin, organizimin dhe përdorimin e laboratorit, si dhe ofron një kuadër të qartë për studentët dhe stafin duke ndjekur rregulla dhe procedura të qarta.
2. Rregullorja do të përcaktojë mënyrën e përdorimit të pajisjeve teknologjike dhe burimeve të laboratorit, si psh kamerat, pajisjet e regjistrimit audio-video, softuerët për redaktim, etj, duke siguruar që ato të përdoren në mënyrë të sigurt dhe efikase nga studentët dhe stafi akademik.

Neni 7

Liria e fjalës dhe liria akademike

1. Asgjë në këtë rregullore nuk synon të ketë efektin e kufizimit të lirisë së fjalës ose lirisë akademike brenda ligjit.
2. Laboratori multi- mediatik LM-UniVlora (radio –vision on line , gazeta on line pod cast libroteka audio, kurse dhe praktika mësimore, press univlora etj) mund të përdoret vetëm si një mjet informimi dhe mësimi pasi mjeti i propozuar të jetë miratuar për përdorim nga organet drejtuese të UV-së.
3. Liria e fjalës dhe liria akademike janë të dyja themelore për funksionimin dhe zhvillimin e një laboratorit mediatik arsimor të suksesshëm. Këto liri krijojnë një hapësirë të sigurt për të eksperimentuar, për të shprehur mendime dhe për të avancuar dijen, duke inkurajuar një mjedis të hapur, të barabartë dhe dinamik për studentët dhe stafin akademik.
4. Në kontekstin e laboratorit mediatik arsimor, kjo do të thotë se të gjithë individët (studentët, stafi akademik, hulumtuesit) kanë mundësinë të shprehin ide, krijime dhe mendime të ndryshme në lidhje me teknologjinë, mediat dhe arsimimin.
5. Kjo liri ka disa aspekte të rëndësishme:
 - a. Studentët dhe pedagogët mund të zhvillojnë dhe shprehin ide të ndryshme mbi përdorimin e teknologjive mediatike dhe risitë në fushat përkatëse, duke kontribuar në një mjedis që nxit krijimtarinë dhe diskutimin kritik. Kjo mund të përfshijë përdorimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE REKTOR

mjeteve multimediale (video, audio, grafikë, etj.) për të pasuruar dhe argumentuar pikëpamjet e tyre.

- b. Liria e fjalës siguron që askush të mos censurohet për mendimet ose qëndrimet që ka, përveçse kur ato shkelin ligje të tilla si ato të shpifjes, urrejtjes apo dhunës. Studentët dhe stafi duhet të kenë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre në mënyrë të hapur, duke pasur gjithmonë parasysh përgjegjësinë për etikën dhe ndershmërinë.
- c. Laboratori mediatik arsimor ofron mundësinë për të eksperimentuar me forma të ndryshme komunikimi dhe të mediatizuar të përcjelljes së informacionit si dhe për të mbajtur debate konstruktive mbi ndikimet e teknologjisë në shoqëri dhe arsim. Liria e fjalës është një mekanizëm që i mundëson individëve të zhvillojnë mendime dhe të testojnë ide të reja.
- d. Ky mjedis ndihmon në stimulimin e mendimit kritik dhe analitik, për të përdorur teknologjinë për të mundësuar një përvojë të pasur dhe dinamike për studentët. Ky është një hapësirë ku eksperimente dhe inovacione në metodat e vullnetarizmit dhe të mësimdhënies mund të realizohen në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar, për të avancuar aftësitë dhe dijen e studentëve.
- e. Liria akademike në laboratorët mediatik arsimor përfshin gjithashtu të drejtën e stafit dhe studentëve për të zhvilluar dhe shprehur pikëpamjet e tyre në lidhje me hulumtimet, duke stimuluar një atmosferë ku llogaritja e ndershme dhe diskutimi kritik janë të pranishme dhe të vlerësuara.
- f. Një laborator mediatik arsimor është një vend ku mendimet dhe praktikat e ndryshme mund të ndërthurën dhe të zhvillohen për të ofruar mundësi të shumta për zgjidhjen e problemeve. Përdorimi i medias dhe teknologjive të reja mund të krijojë mundësi për rritjen e diversitetit të ideve dhe për të mbështetur një mjedis.
- g. Liria akademike dhe e fjalës ndihmon studentët dhe stafin që të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike për të vlerësuar dhe për të përdorur informacionin dhe teknologjinë në mënyrë të drejtë dhe të etikës.
- h. Duke krijuar një mjedis ku liria e shprehjes dhe liria akademike janë të siguruar, studentët angazhohen më shumë në proceset e vullnetarizmit, mësimdhënies dhe hulumtimit, duke kontribuar në një atmosferë që inkurajon të mësuarit e pavarur dhe eksplorimin intelektual.

Neni 8

Përbërja e Labororit Multimedial UniVlora

Laborator Multimedial UniVlora është strukturë në përbërje të Sektorit të Bibliotekave dhe Botimeve dhe posedon:

- a. radio-on line UniVlora,
- b. UniVlora podcast,
- c. gazete UniVlora online,
- d. kurse trajnimi,
- e. botime UniVlora digjitale press,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE REKTOR

f. botime UniVlora print press,
si dhe e shtrin veprimtarinë në çdo hapësirë tjetër që i përket fushës mediatike.

Neni 9

Funksionet e elementeve përbërës të Laboratorit Multimedial UniVlora

Funksionet e elementeve përbërës të LBU-UniVlora përfshijnë:

1. *Radio UniVlora (Laboratori i Radiofonisë)*

Funksioni: Ky sektor i laboratorit mediatik mund të përfshijë një studio të plotë radiofonike ku studentët dhe profesionistët mund të krijojnë dhe transmetojnë programe radio, lajme, dhe intervista. Ajo mund të shërbejë si një hapësirë eksperimentale për të mësuar teknikat e prodhimit dhe transmetimit të përmbajtjes radiofonike, përfshirë përdorimin e pajisjeve për regjistrimin e audios, mikrofona, mikserë dhe software për montimin dhe redaktimin e përmbajtjes.

1.1 *Përgjegjësitë e stafit:*

- Menaxhimi i programeve dhe orareve të transmetimit.
- Trajnimi i studentëve për përdorimin e pajisjeve dhe krijimin e përmbajtjes.
- Prodhimi i programeve, intervistave dhe lajmeve.
- Sigurimi i cilësisë së lartë të transmetimit dhe redaktimit të audios.
- Koordinimi me Sektorin e promovimit, marrëdhënieve me publikun dhe Sektorin IT.

1.2 *Struktura:* Mund të transmetojë lajme, biseda live, muzikë dhe debate studentore.

1.3 *Teknologjia:* Një server streaming dhe platforma për shpërndarje.

1.4 *Programacioni:* Lajme të përditshme, programe të caktuara për edukim dhe argëtim.

2. *Podcast UniVlora*

Funksioni: Kjo është një mundësi për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes auditive në formatin e podcastit. Ky laborator mund të ofrojë mundësi për regjistrimin, redaktimin dhe shpërndarjen e podcasteve, si dhe për zhvillimin e tematikave dhe formateve të ndryshme për audiencën e caktuar. Podcastet mund të mbulojnë çështje nga fusha e arsimit, teknologjisë, kulturës, shoqërisë dhe shumë më tepër.

2.2 *Përgjegjësitë e stafit:*

- Krijimi i skenarëve dhe planifikimi i episodeve të podcast-eve.
- Regjistrimi dhe montimi i podcast-eve, në koordinim me Sektorin IT.
- Shpërndarja e episodeve në platforma të ndryshme në koordinim me Sektorin e Promovimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.
- Sigurimi që podcast-et janë të qarta dhe të lehta për t'u kuptuar nga audienca.

2.3 *Formati:* Episodet mund të jenë edukative, intervista me profesorë dhe studentë, analiza tematike ose përmbajtje kulturore.

2.4 *Drejtimi:* Drejtimi i podcast-eve do të bëhet nga personel dhe studentë të UV: specialistë të medias, drejtues akademikë, pedagogë, studentë, nën mbikëqyrjen e Përgjegjësit të LM-UniVlora.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE REKTOR

2.5 Pajisjet: Mikrofona cilësorë, softwer për regjistrim dhe redaktim

2.6 Platforma shpërndarjeje: live stream dhe çdo platformë tjetër shpërndarjeje, nëpërmjet Sektorit të promovimit dhe marrdhënieve me publikun.

3. *Gazetë UniVlora online*

Funksioni: Ky sektor i laboratorit mund të fokusohet në krijimin e përmbajtjes gazetarie dhe botimin e materialeve të ndryshme, përfshirë artikuj, ese, intervista dhe raporte. Ajo mund të jetë një mundësi për studentët dhe hulumtuesit që të krijojnë përmbajtje të shkruar për gazeta ose botime të tjera akademike, duke përdorur teknika të gazetarisë dhe përgatitjes së materialeve për publikim.

1.1 Përgjegjësitë e stafit:

- Hartimi i artikujve, lajmeve dhe përmbajtjes tjetër për botim.
- Projektimi dhe botimi i materialeve në formatin fizik ose dixhital.
- Kontrolli i cilësisë dhe redaktimi i materialeve për të siguruar saktësinë dhe profesionalizmin e përmbajtjes.
- Koordinimi me Departamentet akademike dhe Sektorin e promovimit dhe marrdhënieve me publikun.

4. *Botime UniVlora, dixhitale dhe print. Krijimi i Përmbajtjes Multimediale*

Funksioni: Ky sektor i laboratorit mediatik përfshin prodhimin dhe botimin e përmbajtjes multimediale në forma të ndryshme, si video, imazhe, infografika, dhe tekste të pasura. Kjo mund të përfshijë krijimin e dokumentarëve, videove edukative dhe artikujve të pasuruar me multimedia për të mbështetur mësimin dhe kërkimin.

4.2 Përgjegjësitë e stafit:

- Prodhimi dhe redaktimi i videove dhe materialeve vizuale.
- Krijimi i infografikave dhe grafikëve për të shpjeguar tema komplekse.
- Integrimi i përmbajtjes multimediale me materialet e tjera të gazetës, podcast-it, dhe librarive digjitale.
- Menaxhimi i botimeve akademike të pedagogëve të UV.

5. *Kurse trajnimi në fushat e gazetarisë dhe komunikimit*

Këto kurse zhvillohen nga specialistët e bibliotekave dhe pedagogët e Medias dhe Komunikimit, sipas një programi të aprovuar nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë.

Neni 10

Roli i Rektoratit në menaxhimin e LM-UniVlora

Detyrat e Rektorit dhe strukturave administrative të Rektoratit për një qendër laboratorike mediatike janë të natyrës mbikqyrëse, menaxhuese, organizative, monitoruese dhe strategjike. Rektori ka për detyra funksionale:

- zhvillon një vizioni të qartë për laboratorin mediatik, duke vendosur qëllime dhe prioritete që përputhen me politikat arsimore dhe kërkesat e zhvillimit të teknologjisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE REKTOR

- b. emëron Përgjegjësin e LM-UniVlora, ekspert i fushës së medias dhe komunikimit, prej Sektorit të Bibliotekave dhe Botimeve.
- c. koordinon hartimin dhe realizimin e programeve radiovizive, podcasteve, moduleve, gazetës.
- d. menaxhon dhe autorizon për angazhimin dhe zbatimin e programeve informuese, drejtimin dhe koordinimin e aktiviteteve të laboratorit, sigurinë e cilësisë së punës, si dhe zhvillimin e mjedisit edukativ dhe inovativ.
- e. siguron financimin dhe burimet e nevojshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e laboratorit, përfshirë teknologjitë dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur aktivitetet mësimore dhe kërkimore, harton kërkesat për buxhetin e laboratorit, duke siguruar që të alokohen burimet e duhura për pajisjet, materialet, trajnimet dhe projektet e kërkimit, zhvillon strategji për të siguruar fonde shtesë për laboratorin, përmes donacioneve, grant-eve, dhe partneriteteve me sektorin publik dhe privat.
- f. menaxhon të drejtat e transmetimit dhe shpërndarjes së produkteve të LM-UniVlora tek institucionet jashtë UV.
- g. zhvillon partneritete me institucione edukative të tjera, si dhe me kompani dhe organizata të industrisë për të siguruar mundësi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, trajnime dhe mundësi punësimi për studentët.
- h. koordinon bashkëpunimin midis laboratorit dhe departamenteve të tjera akademike për të integruar përdorimin e teknologjive dhe metodave multimediale në lëndët e ndryshme.
- i. mbështet zhvillimin e projekteve të reja dhe kërkimeve në fushën e mediave dhe teknologjisë, duke inkurajuar nxënësit dhe staf për të zhvilluar ide kreative dhe të reja që mund të kontribuojnë në fushën e edukimit dhe industrisë mediatike.
- j. mbikëqyr mundësitë për studentët që të angazhohen në projekte dhe aktivitete që zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe krijuese në përdorimin e teknologjisë dhe mediat.
- k. mbikëqyr procesin e rekrutimit të stafit të kualifikuar për laboratorin, duke përfshirë, ekspertë teknikë dhe staf mbështetës, si dhe ofron mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional për ta.
- l. zhvillon dhe implementon politika dhe procedura që lidhen me përdorimin e laboratorit, përfshirë rregullat për përdorimin e pajisjeve, etiket dhe sigurinë e të dhënave.
- m. monitoron mirëfunksionimin e LM-UniVlorës nëpërmjet strukturave administrative të UV.

Neni 11

Përgjegjësi i Laboratorit Multimedial UniVlora

Përgjegjësi i LM-UniVlora ka përgjegjësi të lidhura me menaxhimin dhe organizimin e operacioneve të përditshme të laboratorit, duke siguruar që përmbajtja të jetë cilësore, inovative dhe përmbush nevojat e audiencës. Përgjegjësi të tilla përfshijnë:

- 1. Menaxhimi i Përdorimit të Pajisjeve dhe Teknologjisë në koordinim me Sektorin e IT
 - a. Të sigurohet që pajisjet dhe softwerët për transmetim, montim dhe shpërndarje të jenë funksionale dhe të përditësuar.
 - b. Të mbikëqyrë konfigurimin e platformave për transmetimin online dhe të sigurohet që të gjitha lidhjet dhe kanalet e transmetimit janë të qëndrueshme dhe të disponueshme.
 - c. Të koordinojë teknologjinë për përmbajtje live dhe për prodhimin e materialeve audio.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE REKTOR

2. Planifikimi dhe Krijimi i Përmbajtjes
 - a. Të krijojë dhe të planifikojë programet dhe emisionet, duke siguruar që ato të jenë të larmishme, interesante dhe të përshtatshme për audiencën.
 - b. Të koordinojë dhe mbikëqyrë ndarjen e tematikave të programit dhe të sigurohet që ato të jenë të përditësuara dhe relevante.
 - c. Të sigurohet që emisionet dhe përmbajtja të mbajnë nivelin e duhur profesional dhe etik.
3. Menaxhimi i Stafit dhe Koordinimi i Punës
 - a. Të menaxhojë ekipin e laboratorit, duke u siguruar që secili anëtar të ketë detyrat dhe përgjegjësitë e tij të qarta.
 - b. Të organizojë dhe të udhëheqë stafin për përgatitjen dhe transmetimin e emisioneve, duke koordinuar oraret dhe ndihmuar në ndarjen e detyrave.
 - c. Të mbikëqyrë dhe të ofrojë feedback për performancën e stafit, si dhe të inkurajojë zhvillimin profesional të tyre.
4. Përfshirja dhe Angazhimi i Audiencës
 - a. Të krijojë mundësi për audiencën të angazhohet me përmbajtjen, përmes komenteve, pyetjeve, dhe kërkesave për muzikë ose tematikë.
 - b. Të zhvillojë strategji për të rritur numrin e dëgjuesve dhe për të përmirësuar ndërveprimin me ta përmes platformave digjitale dhe mediave sociale.
 - c. Të organizojë ngjarje dhe aktivitete që mund të inkurajojnë pjesëmarrjen e audiencës, si intervista live, sesione pyetje-përgjigje, dhe konkurse.
5. Marketingu dhe Promovimi
 - a. Të koordinojë veprimet me Sektorin e promovimit dhe marrdhënieve me publikun për publikimin e produkteve të LM-UniVlora.
 - b. Të zhvillojë dhe të zbatojë strategji marketingu për të promovuar stacionin dhe emisionet e tij në koordinim me sektorin e marketingut dhe promovimit
 - c. Të bashkëpunojë me kolegët për krijimin e materialeve promocionale si grafika, video dhe përmbajtje të tjera që mund të shpërndahen në rrjetet sociale dhe platformat online.
 - d. Të ndihmojë në krijimin dhe menaxhimin e fushatave reklamore për të rritur shikueshmërinë dhe degjueshmërinë
6. Sigurimi i Cilësisë së Përmbajtjes
 - a. Të mbikëqyrë cilësinë e përmbajtjes së transmetuar dhe të sigurohet që ajo të përmbushë standardet e larta dhe të jetë përputhshme me etikën profesionale dhe ligjore.
 - b. Të kontrollojë materialet audio dhe të sigurohet që ato të jenë të pastërta, të lexueshme dhe të përshtatshme për audiencën e synuar.
 - c. Të menaxhojë përmbajtjen për të siguruar që ajo të jetë në përputhje me politikat e universitetit dhe të shmangë çdo lloj dezinformimi ose përmbajtjeje të papërshtatshme.
 - d. siguron që shërbimet që ofrohen nga laboratorit, si përdorimi i pajisjeve dhe asistencë teknike, të jenë të përshtatshme dhe të kënaqshme për përdoruesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE REKTOR

Neni 12

Redaksia Studentore e Labororit Multi Mediatik "Univlora"

1. *Statusi dhe qëllimi*

- a) Redaksia Studentore është një njësi strukturore funksionale brenda Labororit Multi Mediatik të Universitetit të Vlorës "Ismael Qemali", që vepron si platformë bashkëpunimi, formimi dhe krijimtarië për studentët në fushën e medias dhe komunikimit.
- b) Qëllimi i Redaksisë Studentore është të:
 - Përfshijë studentët në procesin editorial, gazetarinë e shkruar, prodhimin audio-vizual dhe komunikimin digjital të Universitetit të Vlorës;
 - Krijojë përmbajtje mediatike që pasqyron jetën akademike, kërkimin shkencor, kulturën dhe aktivitetet e komunitetit universitar;
 - Zhvillojë kompetenca profesionale në fushat e gazetarisë, komunikimit publik, medias digjitale dhe prodhimit multimedial;
 - Promovojë lirinë e shprehjes, mendimin kritik, etikën profesionale dhe përgjegjësinë qytetare të studentëve.

2. *Funksionet kryesore*

Redaksia Studentore ushtron funksione të ndryshme brenda platformës mediatike "UniVlora", përfshirë:

- a) Funksionin informues, duke raportuar mbi ngjarjet dhe zhvillimet e rëndësishme akademike, shkencore dhe studentore;
- b) Funksionin përfaqësues, si zë i studentëve dhe kontribues aktiv në komunikimin universitar;
- c) Funksionin formues dhe praktik, duke u ofruar studentëve eksperiencë reale profesionale në fushën e medias;
- d) Funksionin promovues, për vlerat, identitetin dhe imazhin e Universitetit të Vlorës në publik.

3. *Përbërja dhe përzgjedhja*

- a) Redaksia Studentore përbëhet nga studentë të të gjitha fakulteteve, programeve dhe cikleve të studimit në Universitetin e Vlorës.
- b) Përzgjedhja e anëtarëve bëhet përmes një thirrjeje të hapur publike, të shpallur nga Laboratori Multi Mediatik.
- c) Përzgjedhja bazohet në kriteret e motivimit, aftësive shprehëse, interesit për median dhe komunikimin, si dhe kontributit potencial në veprimtaritë redaksionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE REKTOR

- d) Angazhimi në redaksi zgjat një semestër akademik dhe mund të rinovohet në bazë të performancës dhe vlerësimit të bërë nga përgjegjësi i laboratorit.
- e) Përbërja e redaksisë mund të përfshijë deri në 15 anëtarë aktivë, të ndarë sipas fushave funksionale të medias (shkruar, audio, vizuale, digjitale).

4. Organizimi dhe drejtimi

- a) Redaksia Studentore drejtohet nga Përgjegjësi i Laboratorit Multi Mediatik, i cili siguron funksionimin efektiv, cilësinë profesionale dhe respektimin e standardeve etike.
- b) Brenda redaksisë mund të caktohen role funksionale si:
 - Kryeredaktor studentor, që koordinon punën editoriale dhe planifikimin e përmbajtjes;
 - Sekretar redaksie, që ndjek kalendarin e punës dhe dokumenton proceset;
 - Grupi i gazetarisë së shkruar, përgjegjës për artikuj, reportazhe dhe intervista;
 - Grupi i medias audio/podcast, përgjegjës për emisionet dhe përmbajtjen radiofonike;
 - Grupi i medias vizuale, përgjegjës për fotografi, video dhe montazh;
 - Grupi i rrjeteve sociale dhe komunikimit digjital, përgjegjës për publikimin dhe promovimin online të përmbajtjeve.
- c) Të gjitha materialet e përgatitura nga redaksia miratohen paraprakisht nga Përgjegjësi i Laboratorit para publikimit ose transmetimit.
- d) Përveç mbikëqyrjes së përgjithshme, Laboratori mund të caktojë mentorë akademikë për secilin grup funksional, që ofrojnë udhëzime profesionale dhe mbështetje metodologjike.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë

Anëtarët e Redaksisë Studentore kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Të hartojnë artikuj, kronika, reportazhe dhe intervista mbi tema me interes akademik, social, shkencor apo kulturor;
- b) Të përgatisin dhe zhvillojnë emisione radiofonike, podcaste dhe produkte multimediale;
- c) Të ndihmojnë në mbulimin mediatik të aktiviteteve universitare (ceremoni, konferenca, ekspozita, evente studentore);
- d) Të kujdesen për korrektësinë faktike, cilësinë gjuhësore dhe standardet etike të materialeve të tyre;
- e) Të bashkëpunojnë me pedagogë, studentë dhe figura publike për intervista dhe rubrika tematike;
- f) Të marrin pjesë në mbledhjet redaksionale dhe të kontribuojnë në planin editorial periodik;
- g) Të përdorin me përgjegjësi pajisjet dhe infrastrukturën e laboratorit, duke respektuar rregullat e brendshme të përdorimit.

6. Përfitimet dhe njohja e kontributit

Studentët e përfshirë në Redaksi përfitojnë:

- a) Përvojë konkrete profesionale në fushën e medias, gazetarisë dhe komunikimit publik;
- b) Çertifikatë zyrtare për kontributin e dhënë në Laboratorin Multi Mediatik “UniVlora”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË REKTOR

- c) Publikim të emrit në produktet mediatike ku kanë marrë pjesë (artikuj, emisione, podcaste, etj.);
- d) Të drejtën për ta përfshirë këtë përvojë në dosjen profesionale, akademike ose të punësimit;
- e) Mundësi për bashkëpunime me media partnere, projekte kërkimore ose nisma institucionale;

7. Etika dhe përgjegjësia

- a) Anëtarët e Redaksisë Studentore duhet të respektojnë parimet e gazetarisë etike, objektivitetit dhe integritetit akademik.
- b) Çdo material i përgatitur duhet të jetë origjinal dhe të respektojë të drejtën e autorit, privatësinë dhe burimet e informacionit.
- c) Shkeljet e rënda të etikës mediatike, plagjiatura ose përdorimi i pasaktë i platformave mediatike për qëllime personale apo politike mund të sjellin masa disiplinore, përfshirë përjashtimin nga redaksia.

8. Raportimi dhe vlerësimi

- a) Redaksia Studentore raporton periodikisht mbi aktivitetet e saj tek Përgjegjësi i Laboratorit Multi Mediatik.
- b) Në fund të çdo semestri, përgatitet një raport përmbledhës që përfshin: përmbajtjet e prodhuara, pjesëmarrjen e studentëve, vlerësimin e mentorëve dhe rekomandime për përmirësim.
- c) Ky raport paraqitet në Rektorat dhe mund të shërbejë si bazë për miratimin e projekteve të ardhshme, bashkëpunimeve apo shpërblimeve studentore.

Neni 13

Përdoruesit dhe përdorimi i pajisjeve

1. Përdoruesit e brendshëm, si dhe përdoruesit e jashtëm, mund të hyjnë në hapësirat e Laboratorit multimedial të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë dhe të përdorin pajisjet e tij duke respektuar procedurat dhe standartete e vendosura në këtë rregullore. Përdoruesit e brendshëm përkufizohen si ata që janë pjesë e stafit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, studentë, përfshirë studentët doktorantë, bashkëpunëtorë hulumtues si dhe personeli akademik, të cilët kryejnë veprimtari mësimore dhe kërkimore.
2. Hyrja në laboratorë dhe përdorimi i pajisjeve nga përdoruesit e brendshëm lejohet gjatë orarit normal të punës dhe në prani të personelit të autorizuar, si dhe pasi të jetë marrë leje nga autoriteti përgjegjës në UV.
3. Përdoruesit e jashtëm mund të hyjnë në laboratorë vetëm gjatë aktiviteteve edukative-trajnuese të promovuara dhe që zhvillohen në UV ose në mënyrë të pavarur me autorizimin e Rektorit dhe në prani të personelit të autorizuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE REKTOR

Neni 14

Përfshirja e Studentëve Vullnetarë në funksionimin e Laboratorit Multimedial Universitar

1. Studentët janë shtylla kryesore për funksionimin e një laboratorit mediatik universitar, duke kontribuar me entuziazëm dhe ide kreative.
2. Organizimi i një fushatë nëpër kampus dhe në rrjete sociale për të informuar studentët mbi mundësitë për t'u bashkuar si vullnetarë.
3. Ofrimi në përvojë praktike dhe certifikata pjesëmarrjeje që mund të shërbejnë si referenca për karrierën e tyre.
4. Ekspertët e fushës së komunikimit dhe medias mund të ofrojnë mentorim për studentët, duke ndihmuar në përgatitjen e tyre profesionale.
5. Krijimi i Ekipeve ose grupeve të vogla me role specifike për secilën platformë mediatike (podcast, radio dhe gazetë online).
6. Mbledhje periodike duke mbajtur takime të rregullta për të diskutuar progresin, idetë dhe sfidat e hasura.
7. Përfitimet për Studentët në Përvojë Praktike nga praktika direkte në një mjedis mediatik.
8. Rrjetëzimi për Krijimin e lidhjeve profesionale me profesorë, mentorë dhe specialist të fushave të ndryshme
9. Mundësi për të ndërtuar një portofol me përmbajtje të krijuar nga vetë ata.

Neni 15

Roli i studentëve

Studentët vullnetarë mund të vendosën në role të tilla si:

- a. *Gazetarë:* Mbledhja e informacionit, shkrimi i artikujve për gazetën online.
- b. *Podcast-er:* Krijimi i përmbajtjes audio, regjistrimi dhe redaktimi i episodeve.
- c. *Teknikë Radiofonike:* Menaxhimi i transmetimeve live dhe prodhimi i programeve për radion online.
- d. *Marketing dhe Media Sociale:* Promovimi i përmbajtjeve të laboratorit në platformat e mediave sociale dhe krijimi i fushatave dixhitale.
- e. *Dizajnerë Grafikë:* Krijimi i vizualeve dhe dizajnimi i faqeve të gazetës online dhe materialeve promocionale.

Neni 16

Mbrojtja e të dhënave dhe liria e informacionit

1. Objekti i laboratorit mediatik arsimor është të krijojë një mjedis të pajisur me teknologjitë dhe burimet e nevojshme që mundësojnë zhvillimin e aftësive teknologjike, krijuese dhe bashkëpunuese të studentëve.
2. Laboratori multi- mediatik (audio –vision on line , gazeta on line pod cast libroteka audio,kurse dhe praktika mësimore, press univlora etj) perfshin transmetimin e programeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË REKTOR

të informimit dhe informacione arsimore dhe jo vetëm, me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për një publik të caktuar dhe më gjërë, të cilat kryhen nëpërmjet platformës online dhe çdo mënyrë tjetër shpërndarjeje. Gjithashtu përfshin përcaktimin e procedurës mbi mënyrën e publikimit të materialeve për faqet-mediat sociale Facebook, TikTok, Instagram, Youtube.

3. Ky laborator ofron mundësi për informacion dhe dije për tema të ndryshme (shkencë, histori, teknologji, etj.) që mund të ndihmojnë audiencën të mësojë diçka të re, të krijohet një përvojë argëtuese për dëgjuesit, duke përdorur humorin dhe shfaqje të ndryshme për të krijuar një atmosferë relaksuese, të intervistohen ekspertë, individë të njohur, ose persona me histori interesante dhe të ofroni njohuri dhe perspektiva të reja.
4. Diskutime të temave Aktuale, të analizohen dhe diskutohen ngjarje dhe lajme të fundit në një mënyrë të thelluar dhe analitike, duke i ndihmuar dëgjuesit të kuptojnë ndikimet dhe pasojat.
5. Të ofrohet mbështetje dhe këshilla për çështje personale, si për shembull, shëndeti mendor, marrëdhëniet ose zhvillimi personal.
6. Të ndihmohen studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, duke ofruar këshilla për karrierën, përmirësimin e aftësive dhe mundësi për të mësuar nga profesionistë të tjerë.
7. Objekti i laboratorit mediatik arsimor është të krijojë një mjedis të pajisur me teknologjitë dhe burimet e nevojshme që mundësojnë zhvillimin e aftësive teknologjike, krijuese dhe bashkëpunuese të studentëve.

Neni 17

Standardet e pritshme të sjelljes

Në Universitetin e Vlorës, si në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë, janë të rëndësishme standardet e sjelljes në laboratorët mediatik, për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe profesional për studentët dhe stafin. Kjo nënkupton respektimin e parimeve të mëposhtme:

1. Respektimi i etikës profesionale:
 - a) Studentët dhe stafit duhet të tregojnë profesionalizëm dhe etikë në përdorimin e pajisjeve dhe burimeve të laboratorit.
 - b) Ata duhet të respektojnë të drejtat e autorëve dhe të përdorin materialet mediatike duke u përmbajtur nga shkeljet e të drejtave të autorit.
2. Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve:
 - a) Pajisjet dhe materialet që ndodhen në laborator duhet të përdoren me kujdes dhe vetëm për qëllime akademike.
 - b) Pas përdorimit, pajisjet duhet të rregullohen dhe të lihen në gjendje të mirë.
3. Ruajtja e sigurtisë:
 - a) Ndjekja e rregullave të sigurtisë është thelbësore për të shmangur aksidentet, sidomos në përdorimin e pajisjeve teknologjike si kamra, mikroфона, dritat, etj.
 - b) Përdorimi i pajisjeve të sigurtisë kur është e nevojshme, si dhe ndihma për të ruajtur higjienën dhe rendin në laborator.
4. Përgjegjësia gjatë punëve në grup:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE REKTOR

- a) Puna në laboratorët mediatik shpesh bëhet në grupe, prandaj është e rëndësishme të krijohet një atmosferë bashkëpunimi dhe respekti për idetë e të tjerëve.
- b) Çdo anëtar i grupit duhet të kontribuoni në mënyrë aktive dhe të jetë i përgjegjshëm për detyrat e tij.
5. Përmbushja e afateve:
 - a) Studentët dhe stafi duhet të përmbushin afatet e përcaktuara për projekte, detyra dhe aktivitete të laboratorit, për të siguruar që punimet të mbarojnë në kohë.
6. Ruajtja e privatësisë dhe të dhënave:
 - a) Ndjekja e politikave të ruajtjes së privatësisë për çdo informacion që mund të ndodhi në laborator (p.sh., të dhëna të studentëve ose të tretëve).
7. Përkujdesja për mjedisin:
 - a) Përdorimi i materialeve të riciklueshme dhe mbajtja e një mjedisi të pastër dhe të organizuar në laborator është thelbësore për ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe produktiv.

Neni 18 Monitorimi

1. Monitorimi i Labororit Multimedial Universital kryhet prej Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit.
2. Detyrat monitoruese të një laboratorit multimediatike universitar janë të orientuara në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe burimeve që përdoren në laboratorin multimedial. Këto detyra janë të rëndësishme për të siguruar që laboratorit funksionon në mënyrë efikase dhe përmbush objektivat arsimore dhe teknologjike. Këto detyra përfshijnë:
 - a. Monitorimi i përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve teknologjike dhe siguria që ato janë në gjendje pune.
 - b. Mbikëqyrja që përdorimi i pajisjeve të laboratorit të jetë i drejtë dhe i organizuar, duke siguruar që të gjithë përdoruesit të kenë mundësi të barabarta për t'i përdorur.
 - c. Vlerësimi i nivelit të angazhimit dhe përfshirjes së studentëve në aktivitetet e laboratorit, si dhe siguri që ata të përfitojnë maksimumin nga mundësitë që ofron ky laborator.
 - d. Kontrolli që të gjitha aktivitetet që përdorin teknologjinë dhe mediat të jenë në përputhje me ligjet dhe politikat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.
 - e. Monitorimi i kënaqësisë së studentëve dhe stafit në lidhje me shërbimet dhe mbështetje teknike që ofron laboratorit, duke mbledhur dhe analizuar feedback-un për të siguruar përmirësime.
 - f. Sigurimi që burimet e laboratorit të përdoren në mënyrë efikase dhe të optimizuar, për të arritur objektivat e laboratorit multi medial.
 - g. Sigurimi që përdoruesit (studentët, stafi akademik, etj.) janë të motivuar dhe angazhuar në sektorët e përcaktuar të laboratorit dhe se ata marrin mbështetje dhe mundësi për zhvillim.
 - h. Monitorimi i kushteve fizike dhe infrastrukturore të qendrës, duke siguruar që ato të jenë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe kërkimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
REKTOR**

- i. Sigurimi që hapësirat e laboratorëve dhe ambienteve të punës të jenë të rregulluara dhe të përshtatshme për përdorim të sigurt.

**Neni 19
Financimi**

Laboratori mediatik i UV mund të financohet nga të ardhurat e buxhetit të universiteti, donacione ose sponsorë, sipas parashikimeve të rregullores Finaciare të UV-së dhe pas miratimit të Bordit të Administrimit.

**Neni 20
Rregullat përfundimtare**

1. Për çdo gjë që nuk rregullohet shprehimisht në këtë Rregullore, i referohet legjislacionit dhe akteve ligjore në fuqi.
2. Miratimi, rishikimi apo ndryshimi e kësaj Rregulloreje është kompetencë e Senatit Akademik të UV-së.

**Neni 21
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Senatit Akademik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

KRYETARIA E SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AURELA SALIAJ